

Aneksi 7

FTESË PËR OFERTË

Emri: Milieukontakt Shqipëri
Adresa: Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion,
Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri
E-mail: office@milieukontakt.org
Afati i dorëzimit të ofertës: 13 prill 2024

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin “*Të rinjtë për një të ardhme të qëndrueshme*” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 13 prill 2024, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose në adresën postare Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Milieukontakt Shqipëri do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktin sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i produktit	Ditë pune	Çmimi/njësi Me TVSH (ALL)
1.	Udhëzues mbi Objektivat e Zhvillimit të qëndrueshëm	10	
	Totali		

Specifikime të përgjithshme teknike:

- Zhvillimi i metodologjisë për realizimin e një udhëzuesi mbi OZHQ-te
- Informacion i përgjithshëm mbi OZHQ. (Cfarë janë OZHQ, çfarë është zhvillimi qëndrueshëm, cili është statusi i shqipërisë, çfare mund të bëhet më shumë, dhe si mund të kontribuojnë të rinjtë)
- Realizimi i kurrikulave mësimore për të rinjtë e shkollave 9 vjeçare që lidhen me OZHQ - 6,11,13, 15
- Ushtrime praktike dhe aksione konkrete në terren për të arritur OZHQ - 6,11,13, 15
- Eksperti do të ketë në dispozicion 10 ditë pune
- Udhëzuesi të jete në gjuhën shqipe
- Ofrimi i këtij shërbimi kërkohet për periudhën **Prill-Qershor 2024**. Me Subjektin fitues do të lidhet një kontratë.

Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjekti ose personi fizik duhet të jetë i regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Preferohet subjekt ose person fizik që ushtrojnë ekspertizën e tyre në territorin e bashkisë Lushnje;
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email office@milieukontakt.org brenda datës 13 prill 2024 ose në adresën postare Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. **Nuk pranohen ofertat dorazi.**
- 4) PAGESA E SUBJEKTI/ PERSONIT FIZIK KRYHET ME TRANSFERTË BANKARE PAS MARRJES SË SHËRBIMIT DHE LËSHIMIT TË FATURËS PËRKATËSE OSE SUBJEKT I TATIMIT MBI TË ARDHURAT 15% E CILA DO TË ZBRITET SI NJË TATIM NGA TË ARDHURAT PERSONALE.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) CV ku të tregohen eksperiencat e mëparshme;
- 2) Ekstraktin e QKB në rastin kur është subjekt, ose ID në rastin e personit fizik;
- 3) Ofertën financiare për produktin sipas tabelës më sipër;
- 4) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.